3036
ol. 28.6.22

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN**

Nr. 715/3 prot. Elbasan, më 27. 6 .2022

Lënda: Konfirmim akti.

**KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 "*Për Prefektin e Qarkut*", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj Nr. 49 datë 31.05.2022 "*Për caktimin e vendgroposjeve të kadavrave dhe të vendit për tregtimin e kafshëve të gjalla*" dhe pasi u njohëm me të dhënat plotësuese të dërguara nga Kryetari Bashkisë Librazhd me shkresën e tij me Nr. 2917/5prot, datë 22.06.2022, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.
Akti juaj të zbatohet duke respektuar të gjitha proçedurat ligjore në fuqi që kanë lidhje dhe veprojnë në këtë fushë të veprimtarisë.

**PREFEKTI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

**Majlinda PERRIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

08.6.2022

**VENDIM** **Dt.07.06.2022**

Nr.2723/9 prot

**Nr.49 dt.31.05.2022**

PER CAKTIMIN E VENDGROPOSJEVE TE KADAVRAVE DHE TE VENDIT PER TREGTIMIN E KAFSHEVE TE GJALLA

Ne mbeshtetje te ligjit nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore “,Ligjin nr 10465 date 29.09.2011, Per sherbimin veterinare ne Republiken e Shqiperise (I ndryshuar),dhe ne VKM nr.475 date 30.07.2021 ,pika IV,Keshilli Bashkiak i mbledhur sot me date 31.05.2022 dhe me propozim te Kryetarit te Bashkise:

VENDOSI:

1.Te miratoje vendgroposjet e kadavrave te kafsheve sipas planvendosjes dhe relacionit bashkelidhur ketij vendimi.

2.Te miratoje vendin per tregtimin e kafsheve te gjalla sipas planvendosjes dhe relacionit bashkelidhur ketij vendimi.

3.Ndjek zbatimin e ketij vendimi Drejtoria e Bujqesise dhe Ushqimit,Njesite Administrative.

4.Ky vendim hyne ne fuqi 10(dhjete) dite pas shpalljes.

**Sek.i Keshillit**
**Elson Malluta**

KRYETARI I KËSHILLIT
**Shefki Bahiti**

2317/4
dt. 21.06.22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN**

Nr. 719/4 prot. Elbasan, më 15.6.2022

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 *"Për Prefektin e Qarkut"*, përpara se të shprehemi në lidhje me ligjshmërinë e aktit tuaj Nr. 49 datë 31.05.2022 *"Për caktimin e vendgroposjeve të kadavrave dhe të vendit për tregtimin e kafshëve të gjalla"*, referuar VKM Nr. 475 datë 30.7.2021 *"Për bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar"*, kreu ll *"Funksionimi i tregjeve të kafshëve të gjalla, thertoreve dhe kullotave"* pika 1 e tij si dhe kreu lV *"Përcaktimi i vendeve të grumbullimit dhe asgjësimit të kadavrave"* pika 1 e tij, kërkojmë të dimë: Njësia juaj e vetëqeverisjes vendore në përcaktimin e vendgroposjeve të kadavrave dhe të vendit për tregtimin e kafshëve të gjalla – objekt i aktit tuaj, a ka bashkëpunuar me Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve/Drejtoria Rajonale Elbasan si dhe me autoritetet mjedisore rajonale ( si Drejtoria Rajonale e Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë etjerë )

Deri në dërgimin e këtyre të dhënave, akti juaj mbetet i pa konfirmuar.

**PREFEKTI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-ELBASAN-PREFEKTI I QARKUT

**Majlinda PERRIU**